




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.7, datë 23.02.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Gerti”, nëpërmjet HEC Vardari me vendndodhje Kostenjë Bashkia Librazhd Qarku Elbasan sipas Kontratës Nr. 118 Rep., Nr. 60/1 Kol., datë 24.01.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari”, me kapacitet prodhues 1.972 MW, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, amendimit të kontratës Nr. 1818 Rep., Nr. 388/1 Kol., datë 24.12.2020 “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari si dhe shkresës së MIE me nr. 5300 prot., datë 5.7.2021 mbi amendimin e kontratës së ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të HEC Vardari.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:



HEC Vardari niveli I

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 burimi ujqor Përroi i Vardarit

- X= 526263; Y= 4579807; Z=1170 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.24 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.24 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.076 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.019 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 burimi ujqor Përroi i Vaut

- X= 525282; Y= 4580162; Z=1170 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.16 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.16 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.05 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.013 m³/s

HEC Vardari niveli II

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 burimi ujqor Përroi i Kumbullës

- X= 523993; Y= 4579367; Z=972 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.024 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.024 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.008 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.002 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 burimi ujqor Përroi i Sodakut

- X= 524077; Y= 4579558; Z=966 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.176 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.176 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.055 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.014 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 525323; Y= 4578481; Z=700 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.6 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 6.534.170 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1.972 kwh
- Vlera totale e investimit: 242,600,993 lekë me TVSH.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera. Referuar edhe raportit të VNM-së në periudhën e verës, për shkak të kohës së thatë, të mos të ketë punime.



Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

